



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNI



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/69;
Datë: 30.12.2015.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Pr.Port.	Nr. i faq	Data
2-04-61	2	05.01.2016

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komuna; nenit 22.1 paragrafi 4. të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 3. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 30.12.2015, nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e hartimit të

(projekt) **Planit të veprimit për transparencë në komunën e Junikut**

I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) **Planit të veprimit për transparencë në komunën e Junikut** / në tekstin e mëtejme (projekt) Plani/.

II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të këtij (projekt) Plani, sipas këtij vendimi është t'i ofrojë publikut qasje në monitorimin dhe zbatimin e akteve të Komunës së Junikut duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.

III. Bartëse e hartimit të (projekt) Plani nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Administratë e Komunës së Junikut.

IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Plani është e obliguar që Planin ta hartojë në afat prej 4 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

V. Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) Plani nga pika I. e këtij vendimi.

VI. (Projekt) Plani duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Plani në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.

VII. Pas hartimit, (projekt) Plani i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Plani sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Administratë e Komunës së Junikut.

XI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Administratë;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.



Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj

kryesues

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>